

MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

midis

Kolegjit Universitar "UNIVERSUM"-

dhe

"Caritas Kosova"

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellët, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Me anë të këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e bursave të pjeshme akademike për punonjësit e institucionit të lartpërmendur.
2. Bursat ofrohen për nivelin Bachelor dhe Master, dhe janë të aplikueshme për të gjitha programet e akredituara të Kolegjit Universum.
3. Përmes këtij memorandumi, Kolegji Universum merr përsipër ofrimin e zbritjes në cmimin e certifikimit ndërkombëtar Anglia Academy, për stafin e organizatës së lartpërmendur.
4. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit Caritas Kosova do t'ua mundësojë studentëve të Kolegjit Universum përfundimin e internshipit/punës praktike në përkthim me shkrim të materialeve nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas, përfshirë përkthimin gojor konsektiv si dhe organizimin e kurseve të gjuhës angleze (niveli bazik) për fëmijët në Qendrën Sociale të Caritas Kosova në Dubravë-Ferizaj, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të Kolegjit Universum dhe institucionit të lartpërmendur.
5. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, palët dakordohen që të bëjnë shkëmbimin e stafit (në raste të caktuara) për pjesëmarrje në ligjërata publike apo evenimente të organizuara në frymën profesionale.

III. Përzgjedhja e Kandidatëve për Bursa

Përzgjedhja e përfituesve të bursave do të bëhet nga Caritas Kosova duke respektuar kriteret e përgjithshme. Përvoja paraprake dhe mundësia e kandidatëve për tu ngritur në karrierë duhet të merren